



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.74 Prot.

Datë 11.03.2008

**VENDIM**

**Nr.74 datë 11.03.2008**

**Për**

**Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PËRPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11 / 03 /2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg

**Baza ligjore:**

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d), neni 26, dhe neni 43
- Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 47 pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Raportit “Mbi Hetimin e Përgjithshëm në Sektorin e Energjisë” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

Në përfundim të hetimit të përgjithshëm të realizuar në Sektorin e Energjisë vërehet se, ka një përqendrim mesatarisht të lartë të tregut të

shumicës nga disa operatorë, si dhe integrim vertikal i tyre. Sjellja e cmimeve në këtë treg nuk i përgjigjet sjelljes së cmimeve në tregjet furnizuese ndërkombëtare. Tregu mund të karakterizohet nga një konkurrencë e kufizuar e shkaktuar nga firmat me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës .

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 47 pika 2 e Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

### **VENDOSI:**

1. Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurës së hetimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më 11.03.2008

### **ANËTARËT**

**Lush PËRPALI**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

**Anëtare**

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**KRYETARE**